



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0110
Data e Vendimit: 24.02.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “International Security AAH” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër prokurimi 616-24-10100-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës, U.D Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 24.02.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jashtëafatshme, ankesa e OE “International Security AAH” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0110 e datës 11.02.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër prokurimi 616-24-10100-2-1-1, i iniciuar nga Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër prokurimi 616-24-10100-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 11.02.2025, ka pranuar ankesën e OE “International Security AAH” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër prokurimi 616-24-10100-2-1-1, të Komunës së Prishtinës në

cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 25.09.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë B05 dhe me datën 29.01.2025 është publikuar formulari B54 për korrigjim të gabimeve ku Ofertat janë paraparë të dorëzohen jo më vonë se 11.02.2025 14:00.

Operatori Ekonomik “International Security AAH” SH.P.K, me 10.02.2025, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. AK me datën 11.02.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 11.02.2025.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër prokurimi 616-24-10100-2-1-1, me datën 25.09.2024 është publikuar në sistemin e-prokurimi njoftimi për kontratë ndërsa me datën 29.01.2025 AK ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara ku hapja e ofertave është planifikuar me datën 11.02.2025 në ora 14:00.

Operatori Ekonomik “International Security AAH” SH.P.K, me 10.02.2025, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. AK me datën 11.02.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Sipas kësaj dispozite ligjore kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Sipas nenit 4.1 pika a) të Rregullores F03 të Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet te dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim te ofertave pas vendimit për refuzim te kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues me datën 10.02.2025 është parashtruar jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 4.1 pika a) të Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave pasi që kërkesa për rishqyrtim është parashtruar katër (4) ditë para hapjes së ofertave jo pesë (5) ditë siç e parasheh dispozita e lartcekur.

-Përfundim-

Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: “..në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave”. Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas nenit 63.1.1 të kësaj rregulloreje...”.

Autoritetit kontraktues – Komunës së Prishtinës, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik në objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër prokurimi 616-24-10100-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - International Security AAH SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: